



Fletinformacion për çështjen gjyqësore

Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqi (Numri i çështjes KSC-BC-2020-06)

HASHIM THAÇI



Sipas aktakuzës, shef i Drejtorisë Politike dhe asaj të Informimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK); Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (QPK) dhe Kryekomandant i UÇK-së.

KADRI VESELI



Sipas aktakuzës, anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe shef i shërbimit të zbulimit të UÇK-së; shef i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe ministër i Shërbimit Informativ në QPK.

REXHEP SELIMI



Sipas aktakuzës, shef i Drejtorisë Operative të UÇK-së; Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së dhe në fund të marsit 1999, me krijimin e QPK-së, ministër i Rendit Publik/ministër i Punëve të Brendshme në QPK.

JAKUP KRASNIQI



Sipas aktakuzës, anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe zëdhënës zyrtar i UÇK-së; zëvendëskomandant i UÇK-së; zëdhënës i QPK-së.

Aktakuza	Aktakuza e rishikuar u konfirmua më 26 tetor 2020; u bë publike më 5 nëntor 2020. Aktakuza e korigjuar dhe e ndryshuar u dorëzua më 3 shtator 2021 ndërsa aktakuza tjetër e ndryshuar u dorëzua më 29 prill 2022. Më 30 shtator 2022, ZPS-ja e dorëzoi aktakuzën e ndryshuar më të fundit. Një version më pak i redaktuar i aktakuzës u dorëzua më 27 shkurt 2023. Aktakuzën më të fundit mund ta gjeni këtu .
Gjykatës	Gjykatësi i Procedurës Paraprake: Nikola Giju Trupi gjykues II: gjykatësit Çarls Smith III (kryesues), Kristof Barte, Genël Metro dhe Fergal Gejnor (gjykatës rezervë).
Arrestimi/Transferimi/ Paraqitja e parë	Thaçi: u arrestua më 5 nëntor 2020 në Kosovë dhe të njëjtën ditë u transferua në Hagë; paraqitja e parë u mbajt më 9 nëntor 2020: u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës; Paraqitja e mëtejshme më 10 maj 2022: u vetëdeklarua i pafajshëm lidhur me akuzat e reja në aktakuzën e ndryshuar, të dorëzuar më 29 prill 2022. Veseli: u arrestua më 5 nëntor 2020 në Kosovë dhe të njëjtën ditë u transferua në Hagë; paraqitja e parë u mbajt më 10 nëntor 2020: u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës; Paraqitja e mëtejshme më 10 maj 2022: u vetëdeklarua i pafajshëm lidhur me akuzat e reja në aktakuzën e ndryshuar, të dorëzuar më 29 prill 2022. Selimi: u arrestua më 5 nëntor 2020 në Kosovë dhe të njëjtën ditë u transferua në Hagë; paraqitja e parë u mbajt më 11 nëntor 2020: u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e

	<p>aktakuzës; Paraqitja e mëtejshme më 10 maj 2022: u vetëdeklarua i pafajshëm lidhur me akuzat e reja në aktakuzën e ndryshuar, të dorëzuar më 29 prill 2022.</p> <p>Krasniqi: u arrestua më 4 nëntor 2020 në Kosovë dhe të njëjtën ditë u transferua në Hagë; paraqitja e parë u mbajt më 9 nëntor 2020: u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës; Paraqitja e mëtejshme më 10 maj 2022: u vetëdeklarua i pafajshëm lidhur me akuzat e reja në aktakuzën e ndryshuar, të dorëzuar më 29 prill 2022.</p>
Informacion i përgjithshëm	<p>Krimet e paraqitura në aktakuzë ndodhën më së paku midis marsit 1998 deri në shtator 1999, në kontekstin e konfliktit të armatosur dhe në lidhje me konfliktin e armatosur ndërmjet forcave të UÇK-së dhe forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe të Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë.</p> <p>Sipas aktakuzës, Hashim Thaçi, Veseli, Selimi, Krasniqi, dhe anëtarë të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët kishin qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë. Pretendohej se ndër këta kundërshtarë përfshiheshin persona që ishin ose perceptoheshin se kishin qenë: (a) bashkëpunëtorë ose të lidhur me forca, zyrtarë ose institucione të RFJ-së; ose (b) ndryshe nuk mbështetnin qëllimet ose metodat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së, ndër të cilët persona të lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe serbë, romë, dhe persona të kombësive të tjera.</p>
Akuzat	<p>Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi ngarkohen me përgjegjësi penale individuale (neni 16(1)(a) i Ligjit) dhe me përgjegjësi penale si eprorë (neni 16(1)(c) i Ligjit) për:</p> <p>Krime kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje të paligjshme dhe zhdukje me forcë të personave, në bazë të nenit 13 të Ligjit); dhe</p> <p>Krime lufte (arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë, dhe vrasje të paligjshme, në bazë të nenit 14 të Ligjit).</p>
Numri i viktimave pjesëmarrëse	141
Faza e çështjes gjyqësore	Gjykimi

Procedurat para Dhomave të Specializuara të Kosovës

PROCEDURA PARAPRAKE

Më 23 prill 2020, pas njoftimit të bërë nga Prokurori i Specializuar se kishte ndër mend të niste procedim penal, Kryetarja caktoi gjykatësin Nikola Giju si Gjykatës të Procedurës Paraprake.

Më 24 korrik 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi aktakuzën e rishikuar për konfirmim në pajtim me urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e rishikuar kundër të katër të akuzuarve dhe lëshoi fletarrestime dhe urdhra për transferimin e tyre.

Më 9,10 dhe 11 nëntor 2020, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi patën paraqitjen e tyre të parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

Më 21 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesat e nëntë viktimave dhe i pranoi ato si viktimat pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, Grupi I. Më 10 dhjetor 2021, më 25 maj 2022 dhe më 14 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesat e 11, 12 dhe 21 parashtruesve respektivisht si pjesë e të njëjtit grup. Më 20 shkurt 2023, Trupi Gjyqësor miratoi kërkesat e 84 parashtruesve si pjesë e të njëjtit grup. Vendimi më i fundit i Trupit Gjyqësor për pjesëmarrjen e viktimave u mor më 10 mars 2023, kur u pranuan 3 parashtrues të tjerë kërkesash.

Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, përmes dy vendimeve, miratoi pjesërisht mocionet e Mbrojtjes dhe urdhëroi ZPS-në që të korigjojë dhe ndryshojë aktakuzën, mes tjerash, duke përjashtuar përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale III për krime me synim konkret. ZPS-ja e dorëzoi aktakuzën e ndryshuar më 3 shtator 2021.

Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja e dorëzoi si rreptësisht konfidenciale dhe ex parte dosjen e saj paraprake. Versioni i korrigjuar i dosjes paraprake të ZPS-së u dorëzua më 24 shkurt 2022 (gjithashtu si konfidencial). Më 3 prill 2023, ZPS-ja e dorëzoi versionin e redaktuar publik të dosjes paraprake të korrigjuar. Hashim Thaçi dorëzoi versionin e redaktuar publik të dosjes paraprake të tij më 8 nëntor 2022, Kadri Veseli më 13 mars 2023 dhe Selimi e Krasniqi më 8 maj 2023.

Më 23 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e ZPS-së për ndryshim të aktakuzës me qëllim që të përfshijë një numër akuzash të reja. Pas hedhjes poshtë të apeleve të Thaçit dhe Veselit kundër këtij vendimi prej Panelit të Gjykatës së Apelit më 22 mars 2022, ZPS-ja dorëzoi versionin e redaktuar publik të aktakuzës së ndryshuar më 29 prill 2022. Më 22 korrik 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi, pjesërisht, kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit që pretendon mangësi në aktakuzën e fundit dhe gjithashtu urdhëroi ZPS-në që, deri më 30 shtator 2022, të parashtrijë aktakuzën e ndryshuar më tej, me informacion shtesë lidhur me akuzat aktuale. Informacioni shtesë ka të bëjë me emrat e autorëve të drejtpërdrejt të krimeve, viktimave dhe vendodhjeve përkatëse në paragrafet konkrete në aktakuzën aktuale.

Më 29 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e ZPS-së për tërheqjen nga aktakuza të pretendimeve për krime në komunën e Ferizajt dhe urdhëroi ZPS-në që të pasqyrojë këtë tërheqje të akuzave në aktakuzën e ndryshuar më tej, e cila u dorëzua më 30 shtator 2022. Aktualisht, kjo është aktakuza në fuqi për këtë çështje.

Më 30 nëntor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Nikola Giju, njoftoi Kryetaren se dosja e çështjes do të jetë gati për t'ia kaluar Trupit Gjyqes më 15 dhjetor 2022. Më 15 dhjetor 2022, gjykatësi i procedurës paraprake ia kaloi dosjen e çështjes trupit gjyqes II.

Konferenca përgatitore për gjykim u mbajt më 18 janar 2023, pasuar nga Konferenca Përgatitore e Prokurorit të Specializuar më 15 shkurt.

PROCESI GJYQËSOR

Gjykimi do të fillojë më 3 prill 2023.

Më 21 korrik 2023, Trupi Gjyqes miratoi kërkesën e avokatit të viktimave për të lejuar bashkëshortin e mbijetuar të njëres prej viktimave, e cila ka ndërruar jetë së fundmi, të vazhdojë të marrë pjesë në proces gjyqësor në emër të saj. Trupi Gjyqes, në vendimim e shtatë mbi pjesëmarrjen e viktimave, më 7 shtator 2023, pranoi një tjetër viktimitë pjesëmarrëse (kërkesë e ridorëzuar nga një parashtrues i refuzuar më herët).

Zyra e Prokurorit të Specializuar	Mbrojtja	Mbrojtja e viktimave
Ward Ferdinandusse, Alan Tieger, Clare Lawson	<p>Thaçi: Gregori Kiho (Mbrojtës), Dastid Pallaska, Pier Rishar Prosper, Luka Mishetiq, Sofi Menegon, Peter McCloskey Albert Moskowicz dhe Xho Ridër (Bashkëmbrojtës)</p> <p>Veseli: Ben Emerson (Mbrojtës), Endru Strong dhe Ani Orajli (Bashkëmbrojtës)</p> <p>Selimi: Xhefri Robërts (Mbrojtës), Dejvid Jang, Erik Tulli dhe Rudina Jasini (Bashkëmbrojtës)</p> <p>Krasniqi: Venkateswari Alagendra (Mbrojtëse), Eidën Elis dhe Viktor Bëjeshu (Bashkëmbrojtës)</p>	Grupi 1 Sajmon Loz (Mbrojtës), Maria Raxhiovska (Bashkëmbrojtëse)